

V E N D I M
Nr.480, datë 10.10.1994

PËR PULLËN POSTARE SHQIPTARE

Me propozimin e Ministrisë së Transporteve dhe Komunikacioneve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Pulla postare, me cilësinë e letrës me vlerë, shërben për pagesën e shërbimit që kryejnë zyrtarët e postave shqiptare për pranimin, transportin dhe shpërndarjen e korrespondencës postare.

2. Emëtimi i pullave postare bëhet me miratim të ministrit të Transporteve dhe Komunikacioneve. Pranë ministrit dhe nën drejtimin e tij ngrihet këshilli i pullës postare shqiptare. Përbërja dhe numri i anëtarëve në këtë këshill caktohet nga ministri i Transporteve dhe Komunikacioneve.

3. Caktimi i tematikave bëhet nga këshilli i pullës postare shqiptare, i cili, kur e gjykon të nevojshme, bën ndryshime në to. Si rregull, tematika caktohet brenda tremujorit të tretë të vitit pasardhës.

4. Vënia në qarkullim, afati i qarkullimit dhe tirazhi i çdo emsioni të pullave postare shqiptare përcaktohen me miratim të ministrit të Transporteve dhe Komunikacioneve.

5. Çmimi i shitjes së pullave postare shqiptare është jo më i vogël se vlera nominale e shënuar në pullë dhe miratohet nga ministri i Transporteve dhe Komunikacioneve. Për seritë e shkurtuara të vulosura çmimi të jetë jo më pak se 20 për qind e vlerës nominale.

6. Pullat postare shqiptare shtypen në ndërmarrje ose institucioneve të specializuara dhe të autorizuar për shtypjen e letrave me vlerë brenda dhe jashtë vendit.

Për shtypjen, marrjen në dorëzim nga shtypshkronja, për miradministrimin, shpërndarjen dhe shitjen e pullave postare shqiptare përgjigjet ndërmarrja e postave shqiptare, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

7. Për përgatitjen e skicave dhe të bocetave të emisioneve të pullave postare të përcaktuara në programin tematik vjetor, organizohet konkurs. Për kriteret e shpalljes së konkursit dhe dhënien e çmimeve veprohet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.595, datë 29.12.1993 “Për kriteret e shpalljes së konkurseve me karakter kombëtar e lokal dhe dhënien e çmimeve për to”.

Shpërblimet e autorëve do të realizohen nëpërmjet kontratës që ata lidhin me ndërmarrjen e postave shqiptare, e cila përballon këto shpenzime nga të ardhurat.

8. Ndërmarrja e postave shqiptare organizon shitjen e pullave për nevojat e shërbimit nëpërmjet zyrrave të postës dhe subjekteve të tjera, në bazë të kontratës së lidhur me to.

Shitja e pullave postare shqiptare për qëllime filatelike brenda dhe jashtë vendit bëhet nga ndërmarrja e postave shqiptare nëpërmjet tregtarëve dhe agjencive tregtare vendase ose të huaja.

9. Ndërmarrja e postave shqiptare bën publikimin e puallave postare shqiptare nëpërmjet reklamës, materialeve informative, simpoziumeve dhe pjesëmarrjes në ekspozita e panairë kombëtare dhe ndërkombëtare.

10. Për veprimtarinë që kryejnë, anëtarët e këshillit të pullës postare shqiptare marrin një shpërblim vjetor, i cili përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe të ministrit të Transporteve dhe Komunikacioneve.

11. Pranë ndërmarrjes së postave shqiptare funksionon muzeu i pullës, trajtimi i të cilit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e vlerave muzeore.

12. Në zbatim të këtij vendimi, ministri i Transporteve dhe Komunikacioneve nxjerr udhëzimet përkatëse.

13. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.359, datë 6.10.1986 “Për emetimin, prodhimin, administrimin dhe shpërndarjen e pullave postare” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

